



**më afër qytetarit**

funkcionimi i rrugës dykahore zgjedhës - të zgjedhur


**bliže građaninu**

funkcionisanje dvosmernoga puta birač - izabranik

**closer to citizen**

functioning of two-way road elector - elected

[www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)



# PËRMBAJTJA

1. KOMUNA, ROLI, FUNKSIONI DHE PËRGJEGJËSITË (NJOHURI MBI STRUKTURËN KOMUNALE)	3
KORNIZA KUSHTEUËSE	3
RREGULLORJA 2000/45	3
PËRGJEGJËSITË DHE KOMPETENCAT E KOMUNËS	4
ORGANET E KUVENDIT KOMUNAL	5
BORDI I DREJTORËVE; KOMITETET; ANËTARËT E KUVENDIT — TË DREJTAT DHE DETYRAT	6
BUXHETI I KOMUNËS; KONFLIKTI I INTERESAVE	7
2. PJESEMARRJA E QYTETARËVE NË POLITIKË-BËRJE NË NIVEL KOMUNE	8
E DREJTA DHE OBLIGIMI	8
MEKANIZMAT KOMUNALE PËR PJESEMARRJE TË QYTETARËVE	9
TUBIMET PUBLIKE SI SHEMBULL	9
E DREJTA NË PETICION	10
3. TRANSPARENCA — SHMANGIA NGA PRAKTIKAT KORRUPTIVE	10
E DREJTA PËR QASJE	10
ÇKA ËSHTË UDHEZIMI ADMINISTRATIV PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR QASJE NË DOKUMENTET ZYRTARE	11
KUSH DUHET TË MUNDËSOJË QASJE? CILAT DOKUMETE MUND TË KËRKOHEN	12
SI TË KËRKOHET QASJE NË NJË DOKUMENT ZYRTAR	12
NËSE QASJA ËSHTË REFUZUAR	14

## SADRŽAJ

1. OPŠTINA, ULOGA, FUNKCIJA I ODGOVORNOSTI (ZNANJA O OPŠINSKOJ STRUKTURI)	16
USTAVNI OKVIR; ODREDBA 2000/45	16
ODGOVORNOSTI I KOMPETENCIJE OPŠTINE	17
ORGANI SKUPštINE OPŠTINE; IZVRŠNI ODBOR	18
KOMISIJE; ČLANOVI OPŠTINE - PRAVA I DUŽNOSTI; BUDŽET OPŠTINE	19
SUKOB INTERESA	20
2. UČEŠĆE GRAĐANA NA IZRADU NACRT-ZAKONA NA NIVOU OPŠTINE	21
PRAVO I DUŽNOST; OPŠINSKI MEHANIZMI ZA UČEŠĆE GRAĐANA	21
JAVNI SASTANCI KAO PRIMER; PRAVO NA PETICIJU KAO PRIMER	22
3. TRANSPARENCIJA — IZBEGAVANJE OD KORRUPTIVNE PRAKSE	23
PRAVO O UVIDU	23
KO TREBA DA DA UVID; KOJA DOKUMENTA SE MOGU ZATRAZITI	24
KAKO ZATRAŽITI UVID U JEDAN SLUŽBENI DOKUMENAT?	24
AKO JE UVID ODBIJEN	26

## TABLE OF CONTENT

1. MUNICIPALITY, ROLE, FUNCTION AND RESPONSIBILITIES (KNOWING MUNICIPAL STRUCTURE)	28
CONSTITUTIONAL FRAMEWORK; REGULATION NO. 2000/45	28
RESPONSIBILITIES AND POWERS OF MUNICIPALITY	29
THE MUNICIPALITY ORGANS AND BODIES; THE BOARD OF DIRECTORS; COMMITTEES	30
MEMBERS OF THE ASSEMBLY — RIGHTS AND DUTIES; MUNICIPAL BUDGET	31
CONFLICTS OF INTEREST	32
2. PARTICIPATION OF CITIZENS IN POLICY-MAKING IN MUNICIPALITY LEVEL; THE RIGHT AND OBLIGATION	32
MUNICIPAL MECHANISMS FOR CITIZENS' PARTICIPATION	33
PUBLIC MEETINGS AS AN EXAMPLE; THE RIGHT TO PETITION	34
3. TRANSPARENCY — PREVENTION FROM CORRUPTIVE PRACTICES; THE RIGHTS OF ACCESS	34



## STAFI - STAFF - OSOBLJE

**Ismet KRYEZIU**  
*Executive Director*

**Fatmir HAXHOLLI**  
*Project manager*

**Project Coordinators**  
**Fitore ZENELI**  
**Nora VESELI**  
**Driton QENGAJ**  
**Sanije JAHIRI**  
**Bleranda ZOGAJ**

**Vjollca VOGËL**  
*Project Assistant*

**Arsim GJINOVCI**  
*Admin and finance*

**Professional Consultants**  
**Violeta ZEKA**  
**Edita MUSTAFA**

**Përgatiti**  
**ARBEN SHALA**

**Adresa - Address**  
**KDI - Kosova**  
**Democratic Institute**  
email: office@kdi-kosova.org  
web: www.kdi-kosova.org

## 1. KOMUNA, ROLI, FUNKSIONI DHE PËRGJEGJËSITË (NJOHURI MBI STRUKTURËN KOMUNALE)

### Korniza kushtetuese

Në nenin 1.3 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkoħshme në Kosovë, i datës 15 maj 2001, në pjesën e dispozitave themelore, thuhet: Kosova përbëhet nga komunat të cilat janë njësi territoriale, bazë të vetëqeverisjes lokale me përgjegjësitë e caktuara nga legijislacioni i UNMIK-ut që është në fuqi.

Ky nen kushtetues i ka dhënë bazë ligjore funksionimit të qeverisjes lokale, dhe për të përcaktuar organizimin, përgjegjësitë, detyrat dhe obligimet e komunës nga UNMIK-u është hartuar rregullorja që përcakton vetqeverisjen e komunave në Kosovë. Kjo rregullore është miratuar më 11 gusht të vitit 2000 dhe quhet Rregullorja 2000/45.

Rregullorja 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë e datës 11 gusht 2000 është dokumenti i parë ligjor që krijon bazën ligjore për funksionimin e komunave. Rregullorja në fjalë është ende në fuqi dhe realisht ka fuqinë e një ligji të qeverisjes lokale.

### Rregullorja 2000/45

Sipas kësaj rregulloreje, komuna kujdeset që banorët e saj t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik apo mendim tjetër, pa dallim prejardhjeje kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi tjetër.

Në bazë të Rregullores mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr. 2000/45 (seksionit 11.1) Kuvendi Komunal miraton Statutin e vet, si komunë që gëzon statusin e personit juridik dhe qeveris me pasurinë e saj, gjithnjë në pajtim me dispozitat e Rregullores 2000/45. Në secilin Statutit të Komunës mund të gjeni se komunën e përbëjnë qyteti, fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane (të përcaktuara sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000-43). Kuvendi i Komunës me Vendim të posaçëm rregullon numrin dhe organizimin e ofiqarive si degë të deleguara të administratës nëpër fshatra, në pajtim me nevojat dhe mundësitet e

veta. Kuvendi i Komunës me Vendim të veçantë rregullon mënyrën e konstituimit, kompetencat, organizimin, financimin dhe mënyrën e caktimit të udhëheqësive të fshatrave, lagjeve, bashkësive lokale apo njësive të tjera organizative të pushtetit në to.

Komuna e ka rregulloren e vet lokale që i trajton çështjet përbrenda kompetencave të komunës.

### Përgjegjësitë dhe kompetencat e Komunës

Në pajtim me Seksionin 3. të Rregullores 2000/45, Komuna është përgjegjëse për aktivitetet si këto:

1. Ofrimin e kushteve lokale themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik,
2. Planifikimin urban dhe të fshatit, si dhe shfrytëzimin e tokës,
3. Lëshimin e lejeve për ndërtim dhe zhvillime të tjera,
4. Mbrojtjen lokale të ambientit,
5. Implementimin e rregullave ndërtimore dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimeve,
6. Ofrimin e shërbimeve lokale dhe infrastrukturës, duke përfshirë furnizimin me ujë, ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, rrugët lokale, transportin lokal dhe planet për ngrohjet lokale,
7. Shërbimet publike duke përfshirë shërbimet e zjarrëfikësve dhe të emergjencës,
8. Udhëheqjen e pronës së Komunës,
9. Shkollimin paraprak, fillor dhe të mesëm,
10. Kujdesin primar shëndetësor,
11. Shërbimet sociale dhe strehimin,
12. Mbrojtjen e konsumatorëve dhe shëndetin publik,
13. Lëshimin e lejeve për shërbime dhe pajisje, duke përfshirë argëtimin, ushqimin, tregjet, shitjet në rrugë, transportin lokal publik dhe shërbimin e taksistëve, gjuetinë e peshkimin, restorantet dhe hotelet,
14. Panairet dhe tregjet,
15. Emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve dhe rrugicave vendeve të tjera publike në pajtim me dispozitat e Kapitullit 1, neni 9 dhe Kapitulli 2, neni 11/3-i të Rregullores.

16. Sigurimin dhe mirëmbajtjen e parqeve publike, hapësirave të hapura dhe varrezave.
17. Aktivitetet e tjera të ngjashme dhe të rëndësishme për administrimin adekuat të territorit komunal, që nuk janë të përcaktuar gjetiu me ligj.

Secilën nga këto aktivitete komuna e mbulon me Drejtorinë gjegjëse. Si plotësim i aktiviteteve të përmendura më sipër, Komuna mund të marrë veprime të tjera lidhur me çështjet me interes për Komunën, si:

1. Turizmi,
2. Aktivitetet kulturore,
3. Sportet dhe aktivitetet e tjera,
4. Aktivitetet e rinisë,
5. Avancimi i ekonomisë,
6. Avancimi i vlerave qytetare.

### **Organet e Kuvendit Komunal**

Komuna ka organet e veta, të cilat kryejnë funksionet e përcaktuara me Rregullore dhe me Statut.

Organet e Komunës janë – Kuvendi i Komunës, Kryeshefi Ekzekutiv, Kryetari i Kuvendit të Komunës, Zëvendëskryetarët, Komitetet, Kryeshefi Ekzekutiv, Bordi i Drejtoreve, Drejtoritë Komunale dhe cilido person ose organizatë që vepron me autorizimin e Organeve të Komunës.

Komuna ka edhe Avokaturën Publike, e cila punon në pajtim me Ligjin e aplikueshëm mbi Avokaturën Publike.

Kuvendi Komunal aprovon rregullore dhe merr vendime të ndryshme përbrenda kompetencave të komunës. Këto akte kanë për qëllim legalizimin e gjendjes faktike apo hapjen e proceseve të reja në interes të komunës dhe në interest ë qytetarëve. Miratimi dhe publikimi i tyre bëhet në harmoni me Rregulloren dhe Statutin e komunës.

## Bordi i drejtorëve

Kuvendi i Komunës me propozim të Kryetarit të Komunës ka emëruar një Bord të Drejtorëve.

Bordin e Drejtorëve e përbëjnë drejtorët e drejtorive të Komunës dhe Drejtori i Zyrës së Komunitetit.

Bordi i Drejtorëve bien aktvendime dhe akte të tjera juridike nga kompetencat e tyre.

## Komititet

Duke shfrytëzuar direktivat nga Rregullorja 2000/45 (21.1. – për komitetet), Kuvendi Komunal përcakton që komuna të ketë një komitet për politikë dhe financa, një komitet për komunitetet dhe një komitet për ndërmjetësim. Këto komitete konsiderohen si komitete të obligueshme. Sipas 21.2 të Rregullores 2000/45, Komuna mund të krijojë edhe komitete të tjera. Në komuna të ndryshme ka edhe komitete të tjera, të cilat quhen edhe jo të obligueshme.

## Anëtarët e Kuvendit – të drejtat dhe detyrat

Sipas Rregullores 2000/45 (10.2) përcaktohet numri i anëtarëve të Kuvendit komunal për secilën Komunë.

Në kuadër të të drejtave dhe detyrave të Kuvendit, secili anëtar ka të drejtë të marrë iniciativë dhe të bëjë propozime: Kryetarit të Kuvendit, komitetet e drejtorëve të drejtorive, t'u bëjë pyetje dhe të kërkojë informacione dhe sqarime, që nga organet e qeverisjes lokale dhe të shërbimeve profesionale, të kërkojë ndihmë profesionale dhe sqarime të duhura për ushtrimin e funksionit të anëtarit të Kuvendit.

Çdo anëtar i Kuvendit ka të drejtë të paraqesë interpelancën për shqyrtim të çështjeve të caktuara në lidhje me punën e Kryetarit dhe udhëheqësve të tjerë të Komunës, të emëruar nga Kuvendi. Po ashtu çdo anëtar i Kuvendit ka të drejtë në mbledhje të Kuvendit t'i parashtrojë pyetje Kryetarit të Komunës dhe anëtarëve të Bordit të Drejtorëve për çështjet nga fushëveprimi në Komunë.

Anëtarët e Kuvendit për pjesëmarrje në seancat e Kuvendit dhe në mbledhjet e Komitetet e

duhet të lirohen nga ndërmarrja ose institucioni, vendi tjetër i punës ku ata janë në marrëdhënie të rregullt pune.

Brenda kufijve të përshkruar në Seksionin 19 të Rregullores 2000/45, anëtarët e Kuvendit kanë të drejtë në kompensim për punën dhe aktivitetin si anëtarë të Kuvendit

## Buxheti i Komunës

Për Buxhetin e Komunës të hyrat sigurohen nga:

1) Autoriteti Qendoror,

Në pjesën e mjeteve financiare ato formohen prej transferit nga Autoriteti Qendoror Fiskal në Komunë sipas kritereve të parapara për ndarjen e mjeteve komunale.

2) Të hyrat vetanake të Komunës,

Komuna mund të krijojë të hyra vetanake në përputhje me ligjet dhe udhëzimet e Pushtetit Qendoror duke përfshirë metodat në vazhdim□

1) Licencat dhe Pagesat që i cakton Komuna,

2) Të ardhurat nga pasuria e Komunës,

3) Gjobat dhe përqindja e gjobave,

4) Të ardhurat nga shfrytëzimi i infrastrukturës komunale.

3) Donatorët ndërkombëtarë,

Për ta ndihmuar zhvillimin e Komunës, donatorët ndërkombëtarë mund të derdhin mjetet në Buxhetin e Komunës.

4) Nga vetëkontributi i qytetarëve,

Për t'i përbushur më mirë apo përmirësuar nevojat e qytetarëve, Komuna mund të sigurojë mjetë edhe përmes deklarimit të drejtëpërdrejtë të qytetarëve në pajtim me Ligjet e aplikueshme. Mjetet e siguruara në këtë mënyrë mund të shfrytëzohen vetëm për atë qëllim që janë deklaruar qytetarët.

5) Si dhe burimet legjitime që janë të lejuara me ligjet e aplikueshme

## Konflikti i interesave

Sic parashihet në Seksionin 17, 32 dhe 34 të Rregullores 2000/45, delegatët e Kuvendit, Komitetit, Bordit të Drejtoreve, Kryetari, Zv/Kryetari, përjashtohen nga procedurat lidhur

me marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij ose asaj, ka interes personal apo financiar.

Po ashtu, çdo anëtar i Kuvendit dhe funksionar i lartë komunal obligohet që të bëjë deklaratë paraprake me shënime të plota mbi interesat e tyre financiare në momentin e pranimit të funksionit, sikur edhe për çdo ndryshim eventual që ndodh gjatë mandatit.

## **2. PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË POLITIKË-BËRJE NË NIVEL KOMUNE**

### **E drejta dhe obligimi**

Rregullorja 2000/45 parasheh konsultime të obligueshme publike para miratimit të rregulloreve komunale. Ky obligim si i tillë paraqitet edhe në statutet komunale.

Sipas dispozitave identike në statute në Kosovë, Kuvendet Komunale duhen që së paku të zbatojnë këto lloje të pjesëmarrjes dhe konsultimit publik:

- Fushatat publike dhe informative për ngritjen e vetëdijesimit;
- Kontakte me grupet e synuara dhe palët e interesuara;
- Shpallja publike e propozimit, ftesa për përfaqësim dhe mundësimi i së paku 14 ditëve për pranimin e tyre dhe,
- Hulumtimi për vlerësimin e ndikimit

Përveç këtyre, statuti komunal parasheh lloje të tjera të mundshme të konsultimit dhe pjesëmarrjes publike siç janë anketimet që kanë të bëjnë me implementimin e politikave, takimet publike, dëgjimet publike, hetimet publike, komitetet këshillëdhënëse, referendumet etj. Po ashtu, Rregullorja 2000/45, neni 7.1, lejon pjesëmarrjen e publikut dhe të përfaqësuesve të shtypit në të gjitha mbledhjet e kuvendeve komunale dhe të komiteteve.

Në pajtim me Rregullat e procedurës, qytetarët në Komunë mund t'i: - 1. shqyrtojnë dhe propozojnë çështjet me interes publik përmes konsultimeve dhe - 2. përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të tyre në tubime.

## Mekanizmat komunale për pjesëmarrje të qytetarëve

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave të qytetarëve, Komuna mund të përdorë mekanizmat e realizimit, si:

1. Fushatën informative dhe ato të publicitetit për promovimin e programeve dhe aktiviteteve komunale,
2. Kontaktet me qarqe të zgjedhura për ta vënë në sprovë dhe për të diskutuar politikën,
3. Anketat sa i përket implementimit të politikës, ku do të përfshiheshin përvèç tjerash, informues kyç, klientë dhe qytetarë të prekur nga kjo,
4. Shpalljet publike të propozimeve lidhur me politikën apo projektrregullore, duke ftuar pjesëmarrjen me prezantime,
5. Kontaktet kyçë me grupe përkatëse të interesit,
6. Takimet publike
7. Seancat publike,
8. Hetimet publike,
9. Hulumtimi i OP (opinionit publik)
10. Komitetet këshilldhënëse,
11. Referendumet në pajtim me nenin 29-32

Në çdo rast do të jepet një arsyetim i bazuar për zgjedhjen e mekanizmave të konsultimit, apo pjesëmarrjes publike dhe do të lejohet një afat kohor i mjaftueshëm për paraqitjen e propozimeve.

Rezultatet do të merren parasysh dhe do të publikohen para se të merret vendimi përfundimtar.

Komuna dhe komitetet e saj, para miratimit të rregulloreve komunale, praktikojnë konsultë publike, duke i ofruar informata të nevojshme publikut për propozime.

## Tubimet publike si shembull

Në pajtim me Seksionin 8.1 të Rregullores 2000/45, Komuna së paku dy herë në vit duhet të organizojë tubime publike me qytetarët, si formë e realizimit të vetëqeverisjes lokale.

Tubimet e tillë mund të organizohen nëpër fshatra, lagje dhe vendbanime të caktuara.

Në tubimet publike, përfaqësuesit komunalë informojnë pjesëmarrësit për çështjet që i

përkasin interesit të përbashkët për zhvillimin e jetës dhe politikës komunale.

Tubimet janë të karakterit të hapur dhe në to mund të marrin pjesë të gjithë të interesuarit. Pjesëmarrësit në këto tubime mund të marrin iniciativa, të jepin propozime, sugjerime dhe të shprehin mendime për zgjidhjen e çështjeve të caktuara. Nëse shtrohet ndonjë pyetje gjatë tubimit publik, pyetje për të cilën aty për aty nuk mund të jepet përgjigje, parashtuesi ka të drejtë të kërkojë përgjigjen me shkrim brenda 30 ditëve pas mbajtjes së tubimit.

### E drejta në petition

Rregullorja 2000/45 (8.2) jep të drejtën që "...çdo person apo organizatë që ka interes në komunë ka të drejtë t'i paraqesë petition kuvendit komunal për çfarëdo çështjeje rrëth përgjegjësisë dhe kompetencave të komunës. Kuvendi komunal e shqyrton petitionin në pajtim me Statutin dhe rregullat procedurale të tij".

Komuna mund të përkrahë funksionimin e organizatave jo fitimprurëse, duke përfshirë shoqatat e anëtarëve të komuniteteve, nëse organizatat e tillë ofrojnë shërbime në kuadër të përgjegjësisë së përgjithshme të komunës. (6.1)

Komuna mund të bëjë marrëveshje me cilëndo organizatë të tillë me qëllim të ofrimit të shërbimeve. Të gjitha organizatat e tillë duhet ta respektojnë ligjin në fuqi kur i ofrojnë shërbime komunës. (6.2)

## 3. TRANSPARENCA – SHMANGIA NGA PRAKTIKAT KORRUPTIVE

### E drejta për qasje

Shoqërisë kosovare i duhen qytetarë të informuar, ashtu që pastaj angazhohen për problemet e përbashkëta. Pa informata të mjaftueshme dhe lehtë të sigurueshme nuk mund ta kemi as demokracine në të cilën besojmë, e as rritjen ekonomike që e dëshirojmë.

Informatat që mund të sigurohen nga qasja e lirë në dokumentet zyrtare kanë vlera kulturore, ekonomike dhe politike, prandaj janë të nevojshme për shoqërinë kosovare.

Andaj institucionet që përfaqësojnë dhe u shërbejnë qytetarëve kosovarë duhen të mundësojnë qasjen në dokumentet zyrtare, dhe kështu të promovojnë lirinë e informacionit dhe lirinë e shprehjes. Këto liri janë shumë të rëndësishme për të ardhmen e vet këtyre institucioneve dhe gjithë shoqërisë kosovare.

Nga pikëpamja e parimeve demokratike, çdo veprim i qeverisë lokale ose qendrore dhe institucioneve publike bëhet në interesin e përgjithshëm. Këto veprime ndikojnë në të gjithë. Duke pasur qasje në dokumentet zyrtare njerëzit mund të ndikojnë në veprimet që paraqesin shqetësim të përbashkët si për qeverinë ashtu edhe për qytetarët.

Nga pikëpamja e barazisë para ligjit, mundësia e dhënë për qasje në dokumentet zyrtare mund të ndikojë pozitivisht në zvogëlimin e mundësisë për keqpërdorimin e autoritetit dhe të përmirësojë pozitën e qytetarëve karshi administratës. Gjithashtu ndikohet në efektivitetin e punës së administratës duke e bërë atë më efektive sepse punonjësit e administratës do t'u frikësohen kritikave të mundshme në rast se metodat e tyre të veprimit bëhen shumë burokratike.

Institucionet qeverisëse, me anë të ligjit dhe rregullores për qasje në dokumente zyrtare, obligohen për të siguruar qasje në dokumentet zyrtare. Ligji dhe rregullorja vendos në duart e qytetarëve një mekanizëm kontrolli duke iu ofruar mundësi për një ndikim të caktuar në institucionet dhe autoritetet publike të sipërpërmendura. Prandaj edhe inkurajohen të gjithë qytetarët që të shfrytëzojnë mundësitet që u ofrohen nga ligji dhe nga rregullorja në fjalë si dhe mekanizmat e parapara në këto dokumente ligjore.

### **Çka është Udhëzimi Administrativ për zbatimin e Ligjit për qasje në dokumentet zyrtare**

Udhëzimi administrativ (UA) për zbatimin e LQDZ jep kornizën për menaxhimin e dokumenteve zyrtare në institucion dhe përcakton rregullat praktike për zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare.

## Kush duhet të mundësojë qasje?

“...të gjitha institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, organet dhe agjencionet e tyre, AKM, organet komunale dhe agjencionet e tyre si dhe organet dhe zyrat e pavarura të përaktuara ose të themeluara sipas Kreut 11 të Kornizës Kushtetuese”, ku përfshihet:

Komisioni qendoror zgjedhor

Këshilli gjyqësor të Kosovës

Zyra e auditorit gjeneral

Autoriteti i bankave dhe pagesave të Kosovës

Komisioni e pavarur i mediave

Bordi i transmetuesve publikë

HPD dhe HPCC

## Cilat dokumente mund të kërkohen

“të gjitha dokumentet që mbahen në një institucion, të hartuara apo të pranuara nga institucioni dhe që janë në pronësi të tij, në të gjitha fushat e aktiviteteve të institucionit” (LQDZ 3.3), ku “dokument” është:

“çdo përbajtje, pavarësisht nga forma e saj (e shkruar në letër ose e ruajtur në formë elektronike si regjistrim zëri, regjistrim vizual apo audiovizual) lidhur me politikat, aktivitetet dhe vendimet që i takojnë sferës së përgjegjësisë së institucionit.” (LQDZ 2.(b))

## Si të kërkohet qasje në një dokument zyrtar

*Planifikoni kërkesën tuaj:* informohuni nëse lloji i kërkuar i dokumenteve zyrtare është i përashtuar nga qasja e publikut. Kërkoni të shihni listën e të gjitha llojeve të dokumenteve dhe listën e dokumenteve të përjashtuara në atë institucion (UA 12.2).

Vendosni se a do t’ju duhen kopjet e dokumentit zyrtar apo do t’ju mjaftojë qasja e atypëratyshme.

Kërkesa duhet të parashtronhet në çfarëdo forme të shkruar, duke përfshirë formën elektronike (LQDZ 5.1). Kërkoni nga institucioni t’u japë formularin e kërkesës, nëse ka një formular të tillë (UA 11.4).

Nuk është e obligueshme të jepen arsyet për parashtrimin e kërkesës (LQDZ 5.1).

Preferohet që kërkesën t'ia bëni Zyrës së arkivit të institucionit, por atë mund t'ia dorëzoni edhe cilitdo organ ose zyrtar të institucionit (UA 11.1).

Mund të kurseni kohë nëse kërkesën ia bëni Zyrës së arkivit të institucionit, ngase, së pari, kërkesa juaj gjithsesi do të dërgohet për tu regjistruar në Regjistrin e kërkesave, që ruhet në arkiv, dhe së dyti, arkivi mund të ketë kopje të gatshme të dokumentit që kërkon.

Pasi të jetë regjistruar kërkesa, përveç nëse ju mundësohet qasje e atypëratyshme, duhet t'ju lëshohet një njoftim me shkrim mbi pranimin e kërkesës suaj dhe t'ju dërgohet në formën në të cilën është bërë kërkesa (UA 11.6).

Interesohuni për shpenzimet e mundshme.

Vendosni kufizime kohore, p.sh. deri kur më së largu ju nevojitet qasja ose kopja e dokumentit të kerkuar.

Kërkon përgjigje me shkrim brenda 15 ditëve të punës.

### **Mundohuni të përdorni strategjinë e mëposhtme për të evituar refuzimin:**

Pyetni institucionin nëse do të heqë dorë nga përjashtimi dhe nëse po, kur do të lëshojë dokumentin zyrtar.

Nëse institucioni përgjigjet se dokumenti zyrtar nuk ekziston, pyetni se cilat dosje janë kerkuar. Ofroni çfarëdo indikacioni që mund të ndihmojë në gjetjen e dokumentit që e kërkon.

Mos kërkon nga institucioni ose Zyra e arkivit të institucionit që të krijojë një dokument zyrtar ose listë (UA 12.8, vi).

Mos parashtroni kërkesë “në pritje”, kërkesë për dokumente zyrtare që do të krijohen në të ardhmen (UA 12.8, v).

Shpjegimi: Insiston që institucioni të shpjegojë me shkrim pse dokumenti zyrtar i kerkuar është i përjashtuar nga qasja e publikut. Nëse kjo është e mundur të bëhet, riformuloni kërkesën tuaj, ashtu që të mos bie ndesh me shpjegimin për përjashtim ose për refuzim që u është dhënë.

Ankesa: Thirruni në të drejtat tuaja, duke përdorur, në mes tjerave, edhe këtë doracak dhe kërkon të flisni me një zyrtar më të lartë të institucionit.

Pyetni në mënyrë joformale përpara se të thirreni në ligj. Nëse është e domosdoshme, për-

dorni këtë doracak për t'u thirrur në të drejtat tuaja sipas ligjit.

### Nëse qasja është refuzuar

Mbani shënim me kë keni biseduar dhe arsyen për refuzim që u është thënë Institucioni duhet të arsyetojë me shkrim mosdhënien e qasjes në cilindor dokument zyrtar (UA 12.11).

Nëse arsyetimi shpjegon se një ose disa pjesë të dokumentit zyrtar janë të përjashtuara nga qasja, atëherë kërkon që t'u lejohet qasje në pjesën ose pjesët e dokumentit që nuk janë të përjashtuara nga qasja.

Kërkon nga arkivist i që ky të kërkojë nga institucioni ose nga pronari i dokumentit zyrtar rishqyrtimin dhe ndryshimin e njofteimit mbi qasjen e kufizuar në dokument zyrtar të kërkuar (UA 13.3).

### Këshillohuni me mbikëqyrësin tuaj ose me avokatin.

Shkruani një shkrim për media ose letër editorit në lidhje me refuzimin që u është bërë. Nisni procedurën gjyqësore kundër institucionit në pajtim me dispozitat ligjore të ligjit të aplikueshëm relevant dhe/o se të parashtroni ankesë para Ombudspersonit, në pajtim me kreun 10 të Kornizës Kushtetuese dhe Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/38 (LQDZ 7.1).

### Burimet:

Korniza Kushtetuese për Vetqeverisje të Përkohshme në Kosovë  
Rregullorja 2000/45 mbi Vetqeverisjen e Komunave të Kosovës

Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare

Udhëzimi Administrativ3/2006 për zbatimin e ligjit për qasjen në dokumentet zyrtare  
OSBE, Gusht 2007, Raport mbi aktivitetet legjislativë në Komunat e Kosovës



**KOSOVA DEMOCRATIC  
INSTITUTE**

**më afër qytetarit**

funkcionimi i rrugës dykahore zgjedhës - të zgjedhur

**bliže građaninu**

funkcionisanje dvosmernoga puta birač - izabranik

**closer to citizen**

functioning of two-way road elector - elected



## **1. OPŠTINA, ULOGA, FUNKCIJA I ODGOVORNOSTI (ZNANJA O OPŠTINSKOJ STRUKTURI)**

### **Ustavni okvir**

Po članu 1.3 Ustavnog okvira za Privremenu Samoupravu na Kosovu, odobren dana 15. Maja 2001, u deo osnovnih odredba, kaže se: Kosovo se sastoji od opština, koje su osnovne teritorijalne jedinice lokalne samouprave sa nadležnostima koje su utvrđene važećim zakonodavstvom UNMIK-a o lokalnoj samoupravi i opština na Kosovu.

Ovaj ustavni član dao je pranu osnovu funkcionisanja lokalne vlade i, da bi se odredio organizacija, odgovornosti, zadaci i obaveze opštine, od strane UNMIK-a je nacrtana odredba koja određuje samoupravu opština na Kosovu. Ova odredba je odobrena dana 11. Avgusta 2000 godine i imenovana je kao Odredba 2000/45. Ova Odredba je prvi pravni dokument koji stvara pravnu osnovu za funkcionisanje opština, koja je još na snazi i ima snagu zakona o lokalnom vladanju.

### **Odredba 2000/45**

Po ovoj odredbi, opština obezbeđuje da stanovnici opštine uživaju sva prava i slobode bez razlikovanja po rasi, etničkoj pripadnosti, boje kože, pola, jezika, religije, političkog ili drugog mišljenja, nacionalnog ili socijalnog porekla, imovine, rođenja ili drugog statusa. Na osnovu Odredbe br. 2000/45 o Samoupravi opština na Kosovu (sekcija 11.1) Opštinska skupština usvaja svoj Statut, kao opština koja uživa status pravne osobe i vlada sa svojim bogatstvom, uvek u skladu sa poretkom Odrdbe 2000/45.

U svakom opštinskom statutu možete nći da opština se sastoji od grada, sela, naselja i gradske četvrti (određeni po Odredbi 2000/43).

Skupština Opštine sa posebnom Odlukom reguliše broj i organizaciju mesnih zajednica kao delegovane grane administracije po selima, u skladu sa potrebama i mogućnostima. Skupština Opštine sa posebnom Odlukom reguliše način osnovanja, kompetencija, organi-

zacija, financiranja i način imenovanja vođa sela, naselja, mesnih zajednica ili ostalih organizacionih jedinica vladanja.

Opština ima svoju regulaciju koja tretira pitanja unutar kompetencije opštine.

## Odgovornosti i kompetencije Opštine

U skladu sa sekcijom 3. Odredbe 2000/45, opština je odgovorna za delatnosti kao što su:

1. Obezbeđivanje na lokalnom nivou osnovnih uslova za stabilan ekonomski razvoj;
2. Urbanistički planovi za gradska i seoska naselja i korišćenje zemlje;
3. Izdavanje dozvola za izgradnju i ostale vidove razvoja;
4. Lokalnu zaštitu životne sredine;
5. Sprovođenje propisa o izgradnji i standarda za kontrolu izgradnje;
6. Pružanje usluga u vezi sa lokalnim komunalnim uslugama i infrastrukturom što uključuje snabdevanje vodom, kanalizaciju i odvode, čišćenje kanalizacije, odnošenje smeća, lokalne puteve, lokalni prevoz i lokalni sistem grejanja;
7. Opšte službe uključujući vatrogasnu službu i službu hitne pomoći;
8. Upravljanje opštinskom imovinom;
9. Predškolsko, osnovno i srednje obrazovanje;
10. Primarna zdravstvena zaštita;
11. Socijalne službe i stambena izgradnja;
12. Zaštita potrošača i javno zdravlje;
13. Izdavanje dozvola za vršenje usluga i za rad objekata, uključujući zabavu, hranu, pijace, ulične tezge, lokalni javni prevoz i taksi službe, lov i pecanje i restorane i hotele;
14. Sajmovi i pijace;
15. Davanje i menjanje naziva putevima, ulicama i ostalim javnim mestima;
16. Opremanje i održavanje javnih parkova, otvorenih prostora i groblja;
17. Sve ostale delatnosti koje su neophodne za pravilno upravljanje opštinom a koje zakonom nisu dodeljene drugom organu.

Svaku od pomenutih delatnosti opština pokriva odgovarajućim Direktoratom. Kao dodatak delatnostima naznačenim u članu 2.1, opštine mogu da u okviru svojih teritorija

preduzmu mere u vezi ostalih pitanja koja se tiču opštine. Te mere mogu da sadrže sledeće delatnosti:

1. Turizam;
2. Kulturne aktivnosti;
3. Sport i rekreaciju;
4. Omladinske aktivnosti;
5. Ekonomski unapređenja;
6. Promocija građanskih vrednosti;

### **Organi Skupštine Opštine**

Opština ima svoje organe, koje vrše funkcije odrešene sa Odredbom i Statutom.

Organi opštine su: - Skupština Opštine, Predsednik Izvršnog Odbora, Predsednik Skupštine Opštine, Podpredsednici, Komiteti/Komisije, Bord Direktorija, Opštinski Direktoriji i svaka osoba ili organizacija koja deluje sa ovlašćenjem Organa Opštine.

Opština ima i Javnu Pravobranilaštvo, koja radi u skladu sa zakonom u snazi o javnom pravobranilastvu.

Opština odobrava regulacije/propise i donosi razne odluke unutar kompetencija opštine. Ova delovanja imaju za cilj legalizaciju faktičkog stanja ili otvaranje novih procesa u interesu opštine i građana. Odobravanje i njihova publikacija radi se u skladu sa Odredbom i Statuta opštine.

### **Izvršni Odbor**

Skupština Opštine, sa predlogom Predsednika Opštine imenuje Izvršni odbor. Izvršni Odbor sastoji se od direktora opštinskih direktorijata i Direktora Kancelarije Zajednica. Izvršni Odbor donosi odluke i ostale pravne postupke pod svojih kompetencija.

## Komisije

Koristeći direktive iz Odredbe 2000/45 (21.1. – za komisije), Opštinska skupština određuje da ima jednu Komisiju za politiku i finansije, jednu Komisiju za zajednice i jednu Komisiju za posredovanje. Ove komisije se smatraju kao obavezne komisije. Prema šlanu 21.2 Odredbe 2000/45, opština može da stvara i ostale komisije. U raznim opštinama postoje i ostale komisije, koje se nazivaju i neobavezne.

## Članovi Opštine - prava i dužnosti

Prema Odredbi 2000/45 određuje se broj šlanova skupštine opštine za svaku opštinu. U okviru prava i zadataka Skupštine svaki član ima pravo na pokretanje inicijative i da daje prijedloge Predsjedniku Skupštine, Izvršnom predsedniku, komisijama, Direktorima direktorata, da postavlja pitanja i da traži informacije i objašnjenja, da zatraži profesionalnu pomoć i potrebna obaveštenja od strane organa lokalne uprave i profesionalnih službi za obavljanje funkcije člana Skupštine.

Svaki član opštine ima pravo da iznese interpellanciju za razmatranje određenih pitanja u vezi sa radom Predsednika i ostalih vođa Opštine imenovanih od strane Opštine. Takođe svaki član Skupštine ima pravo da na sastanku Skupštine postavlja pitanja Predsjedniku Skupštine, Izvršnom Predsedniku i članovima Borda direktorata o pitanjima delokruga rada u Opštini.

Članovi Skupštine za učestvovanje u radu sjednice Skupštine i na sastancima Komiteta treba da se oslobole od Preduzeća, Institucije ili drugog radnog mjesta gde su u redovnom radnom odnosu.

U okviru granica opisanih u šlanu 19 Odredbe 2000/45, članovi Skupštine imaju pravo naknade za rad i aktivnost kao član Skupštine.

## Budžet opštine

Prihodi za Opštinski budžet obezbeđuju se iz:

## 1. Centralnog Autoriteta,

Deo finansijskih sredstava formira se od transfera Centralnog Fiskalnog Autoriteta u Opštinu, na osnovu kriterija predvidjenim za raspodelu sredstava

## 2. Sopstvenih prihoda Opštine

Opština može formirati sopstvene prihode shodno zakonima i uputstvima Centralne Vlasti obuhvatajući i sledeće načine:

1. Licence i naplate koje određuje Opština,
2. Prihodi od opštinskih imanja,
3. Kazne i postotci kazni,
4. Prihodi od korišćenja komunalnih infrastruktura.

## 3. Međunarodni donatori

Da bi se pomogao razvoj Opštine, međunarodni donatori mogu prelivati sredstva u budžet Opštine.

## 4. Iz samodoprinosa građana

Da bi se bolje ispunili ili potrebe građana, Opština može obezbediti sredstva i preko neposrednog izjašnjavanja građana u skladu sa primjenjivim zakonima. Osigurana sredstva na ovaj način mogu se koristiti samo u svrsi za što su se izjasnili građani.

## 5. Kao i zakonski izvori odobrenih primjenjenim zakonima.

### Sukob interesa

Shodno članu 17, 32 i 34 Odredbe 2000/45, članovi Skupštine, Komisija, Borda Direktorata, Predsednik, Izvršni Predsednik isključuju se iz postupka u vezi sa donošenjem odluka koje se odnose na bilo koja pitanja u kome on ili ona ili neki od bližih članova njegove ili njene porodice, ima lični ili finansijski interes.

Takođe, svaki član Skupštine i visoki Opštinski službenik obavezuje se da sa čini prethodnu izjavu sa potpunim podacima o njihovim finansijskim interesima u momentu prihvatanja funkcije, kao i za svaku eventualnu promenu koja nastane u toku mandata.

## 2. UČEŠĆE GRAĐANA NA IZRADU NACRT-ZAKONA NA NIVOU OPŠTINE

### Pravo i dužnost

Uredba 2000-45 predviđa obavezne javne konsultacije pre odobrenja opštinskih odredba. Ova dužnost kao takav predviđa se i na opštinskim statutima. Prema jednakih dispozicija u opštinskim statutima na Kosovu, Skupštine Opština najmanje trebaju sprovesti ove načine učešća i javne konsultacije:

Javne i informativne kampanje za podizanje svesti

Kontakti sa grupama interesa

Javno obavljanje predloga, poziv na predstavništvo i omogućavanje roka od 14 dana za njihova primanja

Istraživanja i vrednovanja uticaja

Osim gore pomenutim, statut opštine prdviđa i ostale moguće vrste konsultacija i javnog učešća kao što su anketiranja što se tiču primenjenih pitanja, javni sastanci, javna rasprava, javna istraga, savetodavni komiteti, referendumi itd. Takođe Uredba 2000-45, član 7.1. dopušta javno učešće i predstavnika medija na svim sastancima skupštine opštine i sancima komiteta. U skladu sa Pravilnikom Procedure, građani u Opštini mogu da: - 1. raspravljaju i predlažu stvari od javnog interesa putem konsultacija i – 2. da neposredno učestvuju na javnim skupovima.

### Opštinski mehanizmi za učešće građana

S ciljem ispunjenja zahteva građana, Opština može da koristi svoje mehanizme za njenu realizaciju kao:

1. Informativnu kampanju, kao način javnosti za promovisanje svojih programa i aktivnosti.
2. Kontakti sa izbornim okruzima tako da podstiču i raspravljaju o politici
3. Ankete koji se odnose na implementaciju politike, koje će obuhvatati izmedju ostalog vezane informacije, klijente i građane koje su u neposrednom dodiru sa ovim
4. Javno objavljanje predloga vezane za politiku ili nacrt projekata pozivajući učesnike na

### **predstavljanje**

5. Ključni kontakti sa grupama zajedničkog interesa
6. Javni sastanci
7. Javna rasprava
8. Javna instraga
9. Istrazivanja javnog mnjenja
10. Savetodavni komitet
11. Referendumi u skladu sa članovima 29-32

Za svaki slučaj dat će se i osnovano obrazloženje za izbor konsultativnih mehanizama, ili javnoga učešća i če se dozvoliti primereni vremenski rok za dostavljanje predloga.

Rezultati će se dati na uvid i biće publikovani prije nego se donose konačna odluka.

Opština i njeni komiteti prije nego što odobravaju opštinsku odredbu, prakticiraju javnu konzultaciju, ponuđujući javnosti potrebne informacije za predloge.

### **Javni sastanci kao primer**

